



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S Ë
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 1143 Prot.

Tiranë, më 22/11/2017

Lënda: Dërgohen rekomandime lidhur me Projekt-Vendimin “*Për nxitjen dhe shperblimin e punës së të denuarve dhe të paraburgosurve*”.

Drejtuar: **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE**
DRJETOR
Z. ARBEN ÇUKO

Inderuar z. Çuko,

Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi (KMD), është një institucion i krijuar me Ligjin Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrotjen nga Diskriminimi*”, i cili siguron mbrotjen efektive nga diskriminimi dhe çdo lloj sjellje që e nxit atë. Në bazë të ligjit, KMD, ka të drejtë të shqyrtojë ankesa për diskriminim të paraqitur nga individët ose Shoqata që pretendojnë se janë diskriminuar, apo të kryejë hetime administrative kur merr informacione për shkelje të ligjit.

Komisioneri vlerëson qëllimin e këtij projekt-vendimi për përcaktimin e rregullave, kritereve dhe procedurave të punësimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, për maksimalizimin e potencialeve të aftësimit profesional dhe punësimit, duke rritur mundësitë për punësim, brenda dhe jashtë sistemit penitenciar, gjatë dhe pas lirimit nga burgu. I jetet rëndësi kështu dhe mundësisë për lidhje produktive me tregun e punës dhe punëdhënësit, si dhe një shpërbëimi të drejtë për punën e kryer, për t'iu dhënë të burgosurve mundësi më të mira të zhvillimit të aftësive të tyre, të cilat përputhen me tregun e punës.

Komisioneri, pas konsultimit këtij Projekt-Vendimi vlerëson gjithashtu përcaktimin e rregullave, kritereve, si dhe procedurave të punësimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, në përputhje me parashikimet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare; dhe njëherësh vlerëson si të nevojshëm ndërhyrjen apo rregullimin e disa parashikimeve të këtij projekt-vendimi, në përputhje edhe me parashikimet ligjore të Ligjit “*Për Mbrotjen nga Diskriminimi*”. Kemi evidentuar nevojën për ndërhyrje si më poshtë:

1- Në pjesën II, “*Parime të Përgjithshme*”, pika 4 të hiqet termi i përdorur “probleme psiqike”, pasi nuk është në përputhje me Konventën “*Mbi të Drejtat e Personave me Aftesi të Kufizuar*”. Të ndryshohet pika 4 si më poshtë¹: “*Të paraburgosurit dhe të dënuarit që janë me aftesi të kufizuara, mund të vihen në punë duke i ofruar “një përshtatje të arsyeshme”, sipas llojit të punës ose duke e përdorur punën për qëllime terapeutike. Vërtetimi i gjendjes shëndetësore së treguar në këtë pikë do të bëhet kundrejt raportit mjekësor përkatës, të lëshuar sipas legjisacionit në fuqi*”.

2- Në pjesën II, “*Parime të Përgjithshme*”, pika 6 e tij, ku citohet se: “6.Nuk ka diskriminim për shkak të gjinisë në llojin e punës së dhënë”, të ndryshohet në: “*Ndalohet çdo formë diskriminimi², e parashikuar në Kodin e Punës, i ndryshuar, dhe në ligjin “Përmbrojtjen nga diskriminimi”*”.

3- Tek pika 7, ku parashikohet: “Punët që përfshijnë trajnim dhe formim profesional ofrohen për të burgosurit që janë në gjendje të përfitojnë prej tyre, duke iu dhënë përparësi të veçantë të miturve dhe të rinxve”, të shtohet “grave” dhe të ndryshohet në: “*Punët që përfshijnë trajnim dhe formim profesional ofrohen për të burgosurit që janë në gjendje të përfitojnë prej tyre, duke iu dhënë përparësi të veçantë të miturve, të rinxve dhe grave*”.

4- Pika 13, ku citohet se: “Të burgosurit të cilët punojnë, për aq sa është e mundur, përfshihen në sistemet e sigurimeve shoqërore”, të ndryshohet në: “*Të burgosurit të cilët punojnë, përfshihen në sistemet e sigurimeve shoqërore*”. Parashikimi “për aq sa është e mundur”, duke mos parashikuar kushte e kritere, mbetet subjektiv, dhe nga interpretimi dhe zbatimi në praktikë lë shteg për abuzime. Gjithashtu, në thelb cënon të drejtën e sigurimeve shoqërore të burgosurve që punojnë.

5- Të shtohet një pikë tjeter, ku të parashikohet mbajtja e një Regjistri nga administrata e burgut, i cili në përputhje me nenin 95 të Kodit të Punës, përcakton detyrimin për mbajtjen e regjistrat të pagave dhe kontributeve, si dhe të një regjistri të veçantë ku të shënohet për çdo punëmarrës, data e fillimit të punës, lloji i punës, kohëzgjatja, etj.

6- Tek pjesa e V-të “*Shpërblimi për punën e kryer*”, tek pika 6, ku parashikohet “*Punësimi i personave me liri të kufizuar duhet të jetë i hapur ndaj monitorimit të Avokatit të Popullit dhe OJF-ve që monitorojnë standartet e të drejtave të njeriut në këto institucione*”, të shtohet: : “*Punësimi i personave me aftesi të kufizuar duhet të jetë i hapur ndaj monitorimit të*

² Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënинë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftesinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjeter, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion të të dënuarve në burgje apo paraburgim, në të njëjtën mënyrë me të punësuarit jashtë burgjeve”.

Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe OJF-ve që monitorojnë standartet e të drejtave të njeriut në këto institucione”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

